| AKT THEMELIMI I SHOQËRISË "TIMAK AVIATION" SHPK | ACT OF INCORPORATION OF "TIMAK AVIATION" SHPK |
|---|---|
| Në Tiranë, sot më **11.06.2026** *(dy mijë e njëzet e gjashtë)*: | In Tirana, today, on **11.06.2026** (two thousand and twenty-six): |
| **1. Z.Ron Yeffet**, me nënshtetësi shqiptare, i biri i Yitzhak dhe Sarah, i datëlindjes 18.04.1966, lindur në Jerusalem, Izrael dhe rezident në Shqipëri, në adresën: Rr. "Murat Toptani", Qendra e Biznesit "Eurocol", Kati i 4-t Tiranë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr.personal G60418228U, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar; | **1. Mr. Ron Yeffet**, holding Albanian citizenship, son of Yitzhak and Sarah, born on 18.04.1966, born in Jerusalem, Israel, and resident in Albania, at the address: "Murat Toptani" Street, "Eurocol" Business Centre, 4th Floor, Tirana, holder of the identification document with personal no. G60418228U, of full age and with full legal capacity to act, |
| *dhe* | and |
| **2. Znj.Arjeta Puca**, e bija e Shpëtim, lindur më 01.03.1987, e identifikuar me numrin personal I75301107J, me shtetësi shqiptare, banuese në Tiranë;<br>me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacenuar, vendosën të themelojnë shoqërinë **"TIMAK AVIATION" SHPK**: | **2. Ms. Arjeta Puca**, daughter of Shpëtim, born on 01.03.1987, identified by personal number I75301107J, holding Albanian citizenship, resident in Tirana;<br>by their full, free and unimpaired will, decided to establish the company **"TIMAK AVIATION" SHPK**: |
| Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" *(i ndryshuar)*, nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare **"TIMAK AVIATION" SHPK**, me kushtet si vijon: | Based on Articles 6 et seq. of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (as amended), this Deed of Incorporation is hereby signed, whereby the Founding Shareholders express their will to establish the commercial company "TIMAK AVIATION" SHPK, under the following terms: |
| **NENI 1 Emri i shoqërisë**<br>1.1. Emri i shoqërisë do të jetë **"TIMAK AVIATION" SHPK**.<br>1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuara deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. | **ARTICLE 1 Name of the Company**<br>**1.1.** The name of the Company shall be "TIMAK AVIATION" SHPK.<br>**1.2.** The founding shareholders of the Company shall enjoy limited liability up to the unpaid part of their subscribed contributions. |
| **NENI 2 Forma ligjore e shoqërisë**<br>**2.1.** Forma e shoqërisë **"TIMAK AVIATION" SHPK** *(në vijim referuar si "Shoqëria")* do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" *(i ndryshuar)*, derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.<br>**2.2.** Shoqëria është person juridik privat shqiptar dhe gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj. | **ARTICLE 2 Legal Form of the Company**<br>**2.1.** The legal form of the company "TIMAK AVIATION" SHPK (hereinafter referred to as the "Company") shall be a limited liability company (SHPK), in accordance with the provisions of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (as amended), until otherwise decided regarding its transformation into another legal form provided for by the legislation on commercial companies.<br>**2.2.** The Company is an Albanian private legal entity and shall acquire legal personality from the date of its registration. |
| **NENI 3 Selia e shoqërisë**<br>**3.1.** Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: **Rr. "Egnatia", Tirana Industrial Park, Nr.37, Kashar, Tiranë**.<br>**3.2.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. | **ARTICLE 3 Registered Office of the Company**<br>**3.1.** The registered office of the Company is located in Tirana, Albania, at the address: "Egnatia" Street, Tirana Industrial Park, No. 37, Kashar, Tirana.<br>**3.2.** The Company shall have the right to change its registered office to another address and/or city within the Republic of Albania, and shall also have the right to open branches or representative offices anywhere within or outside the territory of the Republic of Albania. |
| **NENI 4 Kohëzgjatja e Shoqërisë**<br>**4.1.** Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.<br>**4.2.** Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm. | **ARTICLE 4 Duration of the Company**<br>**4.1.** The duration of the Company's activity shall be unlimited and shall commence upon the registration of the Company with the National Business Centre.<br>**4.2.** The shareholders of the Company may decide to limit the duration of the activity and subsequently extend it one or more times, pursuant to a special decision.<br>**ARTICLE 5 Scope of Activity**<br>**5.1.** The scope of activity of the Company shall be, but shall not be limited to, the following: |

**NENI 5 Objekti i veprimtarisë**

**5.1.** Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

*Shoqëria ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë në fushën e aviacionit civil, transportit ajror, shërbimeve ajrore dhe shërbimeve mbështetëse të lidhura me to, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.*

*Shoqëria mund të kryejë transport ajror kombëtar dhe ndërkombëtar të pasagjerëve, mallrave, postës dhe ngarkesave të ndryshme, me avionë, helikopterë, private jets, business jets, charter jets dhe çdo mjet tjetër ajror, në pronësi të saj, të marrë me qira, leasing, charter, në administrim apo nëpërmjet operatorëve të tretë.*

*Shoqëria mund të organizojë, ndërmjetësojë dhe ofrojë fluturime private, charter, air taxi, fluturime VIP, executive, corporate, turistike, panoramike, rekreative, emergjence, mjekësore, humanitare, kërkim-shpëtimi, si dhe fluturime të personalizuara sipas kërkesës së klientëve individualë, subjekteve private, institucioneve publike apo organizatave të ndryshme.*

*Shoqëria mund të ofrojë shërbime ajrore të specializuara, përfshirë inspektime, survejime, patrullime, fotografime dhe filmime ajrore, rilevime, hartografi, monitorim të infrastrukturës, linjave energjetike, tubacioneve, zonave industriale, bujqësore, pyjore, bregdetare dhe mjedisore, si dhe shërbime ajrore për shuarje zjarresh, emergjenca civile, spërkatje, dezinfektim, dezinsektim dhe veprimtari të tjera të ngjashme.*

*Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari ndërmjetësimi, brokerimi, përfaqësimi, rezervimi, shitjeje, menaxhimi dhe konsulence në fushën e aviacionit, përfshirë organizimin e fluturimeve me avionë privatë dhe helikopterë, menaxhimin e flotave ajrore, përfaqësimin e operatorëve ajrorë, si dhe krijimin dhe administrimin e platformave fizike ose digjitale për rezervimin dhe menaxhimin e shërbimeve ajrore.*

*Shoqëria mund të ofrojë shërbime aeroportuale dhe ndihmëse, përfshirë ground handling, asistencë për pasagjerë, asistencë VIP, executive, state dhe corporate, koordinim fluturimesh, shërbime fast track, lounge, concierge, catering, transport tokësor, rezervime hoteli, menaxhim bagazhesh, pastrim, dezinfektim, furnizim dhe shërbime të tjera mbështetëse për avionë, helikopterë dhe mjete të tjera ajrore.*

*Shoqëria mund të projektojë, ndërtojë, marrë me qira, japë me qira, administrojë, mirëmbajë dhe shfrytëzojë heliporte, helipad-e, aerodrome, fusha fluturimi, platforma ajrore, vend-parkime për mjete ajrore, hangarë, qendra operacionale, ambiente pritjeje, terminale private dhe çdo infrastrukturë tjetër të lidhur me aviacionin.*

*Shoqëria mund të kryejë ose ndërmjetësojë shërbime mirëmbajtjeje, kontrolli teknik, riparimi, servisimi, parkimi, ruajtjeje, furnizimi me karburant, pajisje, pjesë këmbimi dhe materiale të tjera të nevojshme për operimin e mjeteve ajrore.*

*Shoqëria mund të krijojë dhe administrojë qendra trajnimi në fushën e aviacionit, të organizojë kurse, trajnime, seminare dhe programe formimi profesional për pilotë, pilotë privatë dhe komercialë, teknikë mirëmbajtjeje, personel kabine, personel sigurie, personel handling, personel aeroportual, dispeçerë dhe personel tjetër operacional, si dhe të ofrojë*

*The Company shall have as its object the exercise of activity in the field of civil aviation, air transport, aviation services and related support services, within and outside the territory of the Republic of Albania.*

*The Company may carry out national and international air transport of passengers, goods, mail and various cargo, by aircraft, helicopters, private jets, business jets, charter jets and any other aircraft, owned by it, leased, under leasing, chartered, under management or through third-party operators.*

*The Company may organise, intermediate and provide private flights, charter flights, air taxi services, VIP, executive, corporate, tourist, panoramic, recreational, emergency, medical, humanitarian, search and rescue flights, as well as personalised flights upon the request of individual clients, private entities, public institutions or various organisations.*

*The Company may provide specialised aviation services, including inspections, surveillance, patrols, aerial photography and filming, surveying, cartography, monitoring of infrastructure, power lines, pipelines, industrial, agricultural, forestry, coastal and environmental areas, as well as aviation services for firefighting, civil emergencies, spraying, disinfection, disinsection and other similar activities.*

*The Company may exercise intermediation, brokerage, representation, booking, sales, management and consultancy activities in the field of aviation, including the organisation of flights by private aircraft and helicopters, management of aircraft fleets, representation of air operators, as well as the creation and administration of physical or digital platforms for the booking and management of aviation services.*

*The Company may provide airport and ancillary services, including ground handling, passenger assistance, VIP, executive, state and corporate assistance, flight coordination, fast track services, lounge services, concierge services, catering, ground transport, hotel bookings, baggage management, cleaning, disinfection, supply and other support services for aircraft, helicopters and other aircraft.*

*The Company may design, construct, lease, sublease, administer, maintain and operate heliports, helipads, aerodromes, airfields, aviation platforms, aircraft parking areas, hangars, operational centres, waiting facilities, private terminals and any other infrastructure related to aviation.*

*The Company may carry out or intermediate maintenance, technical inspection, repair, servicing, parking, storage, fuel supply, equipment supply, spare parts supply and other materials necessary for the operation of aircraft.*

*The Company may establish and administer training centres in the field of aviation, organise courses, training sessions, seminars and professional training programmes for pilots, private and commercial pilots, maintenance technicians, cabin crew, security personnel, handling personnel, airport personnel, dispatchers and other operational personnel, as well as provide the relevant certifications, attestations or confirmations, in accordance with the legislation in force.*

*The Company may carry out import, export, purchase, sale, rental, leasing, administration and trading of aircraft, spare parts, equipment, accessories, technical systems, navigation, communication and security systems, and other aviation-related products.*

*The Company may carry out any other commercial, service, technical, financial, consultancy, investment, intermediation or representation activity directly or indirectly related to its scope of activity, as well as participate in companies, partnerships, collaborations or other ventures, within and outside the country.*

*certifikime, dëshmi apo vërtetime përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.*
*Shoqëria mund të kryejë import, eksport, blerje, shitje, qira, leasing, administrim dhe tregtim të mjeteve ajrore, pjesëve të këmbimit, pajisjeve, aksesorëve, sistemeve teknike, sistemeve të navigimit, komunikimit, sigurisë dhe produkteve të tjera të lidhura me aviacionin.*
*Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare, shërbimi, teknike, financiare, konsulence, investimi, ndërmjetësimi apo përfaqësimi që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj, si dhe të marrë pjesë në shoqëri, partneritete, bashkëpunime apo sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit.*
*Veprimtaritë që kërkojnë licencë, autorizim, certifikim, akreditim ose miratim të posaçëm do të ushtrohen nga shoqëria vetëm pas pajisjes me dokumentacionin përkatës nga organet kompetente.*
**5.2.** Shoqëria ka të drejtë të shtojë, pakësojë apo ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

**NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**
**6.1.** Kapitali bazë i Shoqërisë është në vlerën prej **ALL 100.00** (njëqind lekë), i ndarë në **2 (dy) kuota**, me vlera nominale përkatësisht **ALL 50.00** *(pesëdhjetë lekë)* dhe **ALL 50.00** *(pesëdhjetë lekë)*, të cilat përfaqësojnë në tërësi **100%** të kapitalit bazë të Shoqërisë.
**6.2.** Kapitali bazë i Shoqërisë zotërohet nga ortakët themelues si më poshtë:
- **Ron Yeffet** zotëron **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale **ALL 50.00** (pesëdhjetë lekë), e cila përfaqëson **50%** të kapitalit bazë të Shoqërisë.
- **Arjeta Puca** zotëron **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale **ALL 50.00** (pesëdhjetë lekë), e cila përfaqëson **50%** të kapitalit bazë të Shoqërisë.

**6.3.** Ortakët themelues kanë detyrimin të shlyejnë kapitalin bazë të shoqërisë në tërësinë e tij brenda **6** *(gjashtë)* muajve nga data e regjistrimit të shoqërisë.

**NENI 7 Organet Drejtuese**
**7.1.** Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" *(i ndryshuar)*, organet drejtuese të Shoqërisë janë:
1. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**, e cila është organi më i lartë vendimmarrës;
2. **Administratori**, i cili është organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

**7.2.** Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

**NENI 8 Administrimi**
**8.1.** Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme. Administratori mund të jetë i çdo kombësie dhe nuk është e domosdoshme që të jetë rezident në Shqipëri.
**8.2.** Në momentin dhe për qëllimin e miratimit të këtij Akti Themelimi, Administrator i shoqërisë "TIMAK AVIATION" SHPK do të jetë **Znj. Arjeta Puca**, e bija e Shpëtim, lindur më 01.03.1987, e identifikuar me numrin personal I75301107J, me shtetësi shqiptare, banuese në Tiranë.

*Activities requiring a licence, authorisation, certification, accreditation or special approval shall be exercised by the Company only after obtaining the relevant documentation from the competent authorities.*
**5.2.** The Company shall have the right to add to, reduce or amend its scope of activity, in accordance with the provisions of the legislation in force.

**ARTICLE 6 Capital of the Company**
**6.1.** The registered capital of the Company is in the amount of **ALL 100.00** (one hundred Lek), divided into 2 *(two)* shares, with respective nominal values of **ALL 50.00** *(fifty Lek)* and ALL **50.00** (fifty Lek), which together represent 100% of the registered capital of the Company.

**6.2.** The registered capital of the Company is held by the founding shareholders as follows:
- **Ron Yeffet** holds **1 (one) share**, with a nominal value of **ALL 50.00** (fifty Lek), which represents **50%** of the registered capital of the Company.
- **Arjeta Puca** holds **1 (one) share**, with a nominal value of **ALL 50.00** (fifty Lek), which represents **50%** of the registered capital of the Company.

**6.3.** The founding shareholders shall have the obligation to pay up the registered capital of the Company in full within 6 (six) months from the date of registration of the Company.

**ARTICLE 7 Governing Bodies**
**7.1.** Based on the provisions of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (as amended), the governing bodies of the Company are:
1. The General Meeting of Shareholders, which is the highest decision-making body;
2. The Administrator, who is the executive and administrative body of the Company.

**7.2.** The manner of their organisation and functioning is defined in the Articles of Association of the Company.

**ARTICLE 8 Administration**
**8.1.** The Company shall be administered by one or more Administrators, pursuant to a decision of the General Meeting. The Administrator may be of any nationality and it shall not be necessary for him/her to be resident in Albania.
**8.2.** At the time and for the purpose of the approval of this Deed of Incorporation, the Administrator of the company "TIMAK AVIATION" SHPK shall be **Ms. Arjeta Puca**, daughter of Shpëtim, born on 01.03.1987, identified by personal number I75301107J, holding Albanian citizenship, resident in Tirana.
**8.3.** The Administrator shall be appointed for a term of **3 (three) years**, with the right of reappointment, such term commencing from the date of registration of the Company with the National Business Centre.
**8.4.** The Company shall be represented before any administrative body, judicial body or any other public or private entity, as well as in relations with third parties, by the Administrator of the Company or by one or several persons authorised by him/her, in accordance with the Articles of Association of the Company and the Albanian legislation in force.

**8.3.** Administratori emërohet për një afat **3 (tre) vjeçar**, me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**8.4.** Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor apo çdo entiteti tjetër publik ose privat, si dhe në marrëdhënie me të tretët, nga Administratori i Shoqërisë ose nga një apo disa persona të autorizuar prej tij/saj, në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

**NENI 9 Ligji i aplikueshëm**

**9.1.** Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të shoqërisë.

**NENI 10 Regjistrimi**

**10.1.** Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori i Shoqërisë dhe/ose nga një apo disa persona të autorizuar prej tij/saj për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**NENI 11 Dispozitat përfundimtare**

**11.1** Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën fuqi juridike, dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**
**"TIMAK AVIATION" SHPK**

**Z. Ron YEFFET** **Znj.Arjeta PUCA**

**ARTICLE 9 Applicable Law**

**9.1.** The activity of the Company shall be governed by the legislation in force in the Republic of Albania, this Deed of Incorporation, as well as the provisions of the Articles of Association of the Company.

**ARTICLE 10 Registration**

**10.1.** The Company shall be registered with the National Business Centre by the Administrator of the Company and/or by one or several persons authorised by him/her for this purpose, in accordance with the legislation in force.

**ARTICLE 11 Final Provisions**

**11.1.** This Deed of Incorporation is drafted in 3 (three) original copies, in the Albanian language, each having the same legal force, and is duly signed by the founding shareholders of the Company.

**FOUNDING SHAREHOLDERS OF THE COMPANY "TIMAK AVIATION" SHPK**

**Mr. Ron YEFFET** **Ms. Arjeta PUCA**